

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	622-26-2697-1-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **“Furnizim me medikamente dhe material shpenzues për banorët e shtëpisë rezidenciale dhe shtëpisë së pleqëve”.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

MESE PHARM SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Orlloviq, pn

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344122204

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Valdet Jupolli

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

mesepharm@gmail.com

(Adresa elektronike)

28.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Data e njoftimit për kontratë: 27.04.2026
Hapja e ofertave: 18.05.2026
Njoftimi mbi venidmin: 17.07.2026
Kërkesa për rishqyrtim: 20.07.2026
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 21.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.27.04.2026, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 18.05.2026.

Tek njoftimi mbi vendimin është rekomanduar për kontratë OE MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, PRISHTINË me çmimin prej 54,444.90, kurse kompania jonë është

shpall e papërgjegjshme me arsyetimin si më poshtë:

“Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat etyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 90.000,00 € të deshmuaara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve.

Operatori Ekonomik MESE PHARM SH.P.K. në dosjen e tij ka dorëzuar vetëm një LISTË të projekteve PA ASNJË REFERENCË apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve sipas kontratave.

Autoriteti Kontraktues me datë 28/05/2026 ka kërkuar dokumente shtesë B-47 letër standarde nga OE për referencat sipa natyrës së kontratave si në listën e projekteve të dorëzuar nga OE në dosjen e tij.

Gjithashtu po në kët B-47 letër standarde i është dhënë vërejta OE se referencat të cilat janë lëshuar nga operatorët ekonomik privatë duhet të dërgohen edhe transaksionet bankare (pagesat e faturave me bankë) ashtu siq e thot edhe ligji i PP.

Autoriteti Kontraktues me datë 01/06/2026 ka pranuar këto dokumente shtesë të dërguar nga operatori ekonomik si më poshtë:

- Referenca e lëshuar nga OE ALOKA shpk në shumën prej 6.000,00 euro, i mungon transaksioni bankar i kërkuar.
- Referenca e lëshuar nga OE MEDPLUS në shumën prej 4.450,00 euro, i mungon transaksioni bankar i kërkuar.
- Referenca e lëshuar nga OE ALOKA shpk në shumën prej 12.000,00 euro, i mungon transaksioni bankar i kërkuar.
- Referenca e lëshuar nga OE Islamic Relief Kosova në shumën prej 4.488,00 euro, i mungon transaksioni bankar i kërkuar.
- Referenca e lëshuar nga OE MEDPLUS në shumën prej 5.002,12 euro, i mungon transaksioni bankar i kërkuar.
- Referenca e lëshuar nga Komuna e Skenderajt në shumën prej 9.507,80 është valide.
- Referenca e lëshuar nga Komuna e Mamushës në shumën prej 5.579,43 është valide.
- Referenca e lëshuar nga Komuna e Zveqanit në shumën prej 9.992,86 është valide.
- Kontrata me SHSKUK me nr.220-24-13203-111 për fletëdergesat dërguara OE të cilat kan edhe FLETËPRANIMET-RECEIVING LIST në barnatore me nënshkrime të komisionit kapin shumën gjithsejt: 23.445,28 euro

Operatori Ekonomik MESE PHARM SH.P.K. ka gjithsejt 48.525,37 euro referenca valide”

- Në lidhje me këtë arsye të eliminimit, sqarojmë se autoriteti kontraktues ka vepruar

në mënyrë ë njëanshme dhe diskriminuese e po ashtu edhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes s ë tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht në kundërshtim edhe me nenin 56.3 të LPP-së.

Tek neni 9.1&9.2 i FDT-së është kërkuar si më poshtë:

Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat etyre, vlера, minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 90.000,00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kapacitetit teknik dhe profesionale të referencave të natyrës së kontratës.

Dëshmi e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve.

Siç shihet tek kërkesa e lartcekur, nuk është kërkuar që për punët me institucionet private të ofrohen transaksionet bankare, ndërsa autoriteti kontraktues në kërkesën e dt.28.05.2026 për sqarime shtesë përveç referencave ka kërkuar që ne ti ofrojmë edhe transaksionet për kontratat me institucione private. Ne, me përgjigje i kemi dorëzuar referenca sipas kërkesës, mirëpo nuk i kemi dorëzuar transaksionet bankare, pasi që nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Kërkesa për sqarim të tenderit (për transaksionet bankare) nuk është e bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, e po ashtu eliminimi i kompanisë tonë është kundërligjor sepse neni 56.3 i LPP-së e cek qartë:

“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Mbi këtë bazë, ne e kundërshtojmë fuqishëm këtë arsye të eliminimit dhe pikërisht mbi bazën e dispozitës së nenit 56.3 të LPP-së, ne nuk i kemi ofruar me sqarime transaksionet bankare për furnizimet me institucione private.

Sa për dëshmi, ne me kërkesë për rishqyrtim i kemi bashkëngjitur transaksionet bankare për furnizimet që janë kryer me institucionet private, e po ashtu **po ju bashkëngjisim edhe me këtë ankesë**, edhe pse këto dëshmi nuk kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit.

Sa i përket vlerës së kontratave të kërkuara, sqarojmë se e tejkalojmë vlerën e kontratave të kërkuara, prandaj e plotësojmë kërkesën e FDT-së plotësisht dhe normalisht që duhet të konsiderohet oferta jonë përgjegjshme.

Shih më poshtë listën e kontratave të dorëzuara nga ne në këtë tender.

Lista e kontratave

Nr.	Autoriteti Kontraktues/Bleresi	Titulli i Kontratës/Pershkrimi; Nr.kontrates	Data e Nënshkrimit Kontratës	Data e Përfundimit të Kontratës	Vlera e Kontratës	Data referencës/Raporti pranimit
1	Spitali Special Për Kirurgji Aloka SH.P.K.	Furnizim me barna dhe pajisje medicinale; M01	03.01.2025	31.03.2025	€ 6,000.00	01.04.2025
2	SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS	Furnizim me Barna nga LE për SHSKUK-162, 00220-24-13203-1-1-1/C1176	20.02.2025	20.02.2026	€ 37,490.00	17.11.2025
3	Medplus SH.P.K.	Furnizim me produkte dhe pajisje medicinale; M02	01.05.2025	20.05.2025	€ 4,540.00	20.05.2025
4	Spitali Special Për Kirurgji Aloka SH.P.K.	Furnizim me barna dhe pajisje medicinale; M03	01.04.2025	30.06.2025	€ 12,000.00	30.06.2025
5	Islamic Relief	Furnizim me barna dhe pajisje medicinale; M04	01.07.2025	31.07.2025	€ 4,488.00	31.07.2025
6	Medplus SH.P.K.	Furnizim me produkte dhe pajisje medicinale; M05	15.07.2025	11.08.2025	€ 50,002.12	11.08.2025
7	Komuna e Zvecanit	Furnizim me barna për nevojat e AMF-ve Zhahe dhe Lipe R	01.08.2025	11.08.2025	€ 9,992.86	02.10.2025
8	Komuna e Mamushes	Furnizimi me material shpenzues medicinal për laborator të QKMF-s në Mamushë	25.08.2025	04.09.2025	€ 5,579.43	09.12.2025
9	K.K. Skenderaj	006-Furnizim me barna dhe material shpenzues për QKMF në Skenderaj; 643-25-6072-1-3-6	20.08.2025	02.09.2025	€ 9,507.80	12.12.2025



Nga lista e kontratave të dorëzuara kuptohet se ne e tejkalojmë vlerën e kërkuar të kontratave, mirëpo autoriteti kontraktues nuk ka marr parasysh të gjitha kontratat dhe nuk ka dhënë ndonjë arsyetim për këtë veprim.

AK-së gabimisht ka konsideruar se vlera e kontratës me OE MEDPLUS është në shumën prej 5.002,12 euro, sepse kjo kontratë ka qenë në vlerë prej 50,002.12 euro.

Vlera totale e kontratave arrin shumën prej 139,600.21 €.

Kur kem parasysh këto dëshmi atëherë kërkojmë nga OSHP që të analizoj në detaje dëshmitë e ofruara nga ne dhe të detyroj AK-së që të rishqyrtojë vendimin e tyre me qëllim të trajtimit në mënyrë të barabartë të ofertës tonë dhe respektimit në tërësi të procedurave ligjore dhe dispozitave materiale.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim na është dërguar me dt.21.07.2026, ku arsyetimi i AK-së është formuluar si më poshtë:

“OE MESE PHARM SH.P.K. në ofertën fillestare ka dorëzuar vetëm një listë të projekteve, pa asnjë referencë apo procesverbal të pranimit të furnizimeve konform kërkesës së AK.

Prandaj AK, me letrën standarde B-47 të datës 28.05.2026, i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit, gjithashtu duke ja bër me dije OE po në ket letrë standarde për referencat private jeni të obliguar të dërgoni edhe transaksionet bankare.

Me dokumentet e dorëzuara më 01.06.2026, OE nuk ka dorëzuar transaksionet bankare për referencat e lëshuara nga Operatorët Ekonomik privat si : ALOKA SH.P.K. (6,000.00 € dhe 12,000.00 €), MEDPLUS (4,450.00 € dhe 5,002.12 €) dhe Islamic Relief Kosova (4,488.00 €), përkundër kërkesës së AK-së.

Si valide janë vlerësuar vetëm referencat e Komunës së Skenderajt (9,507.80 €), Komunës së Mamushës (5,579.43 €), Komunës së Zveçanit (9,992.86 €) dhe kontrata me SHSKUK në vlerë 23,445.28 €, në total 48,525.37 €.

Rrjedhimisht, OE nuk ka dëshmuar përmbushjen e vlerës minimale prej 90,000.00 €, prandaj nuk i plotëson kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional. Pretendimi se një kontratë me MEDPLUS ka qenë në vlerë 50,002.12 € nuk ndryshon rezultatin e vlerësimit, pasi dokumentacioni i vlefshëm i kërkuar nuk është dorëzuar gjatë fazës së vlerësimit”.

Arsyetimi i AK-së në vendimin për refuzim nuk ka asnjë bazë ligjore dhe nuk është dhënë asnjë argument se përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.

AK-së nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me pretendimin tonë ankimor se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave duhet të bëhet konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ashtu siç parashihet tek neni 59.4 i LPP-së.

Arsyetimi i AK-së, se vendimi për eliminim është marr në përputhje me dosjen e tenderit dhe dispozitat e LPP-së është plotësisht i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, sepse në dosje të tenderit nuk është kërkuar që të ofrohen transaksionet bankare, prandaj vendimi për eliminim është plotësisht në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit

Autoriteti kontraktues në këtë procedurë të prokurimit ka vepruar arbitrarisht duke kërkuar dokumente që nuk janë kërkesë e dosjes së tenderit, e po ashtu ka vepruar arbitrarisht kur na ka eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e vendosur në dosje të tenderit, duke mos respektuar parimin e ligjshmërisë, konkretisht nenin 56.3 të LPP-së.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën tonë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pse jemi OE i përgjegjshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne edhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe parimi i economicitetit konform nenit 6 të LPP-së, pasi që ne kemi ofertuar me çmim prej 47,246.65 euro, kurse OE i rekomanduar për kontratë me çmim prej 54,444.90 euro.

Pra, ne kemi ofertuar me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë prandaj kërkojmë nga autoriteti kontraktues të korrigjojë vendimin e saj dhe të mos lejojë dëmtimin e buxhetit me veprimet e saja.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji

është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden më lartë, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

1. **APROVOHET**, e bazuar ankesa e **MESE PHARM SH.P.K**
2. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 1,500.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.